



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:090891  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05527718

PAKR.nr.102/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku- kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. I për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtëses të akuzuarit S. I, av. Qendres Muriqi Mekaj, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.65/2023 i datës 30.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.65/2023 i datës 30.11.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për të Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.65/2023 të datës 30.11.2023, të akuzuarin S. I për shkak të veprës penale blerja,

posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën pesëqind euro (500 €), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje gjashtë (6) muaj.

Të akuzuarit S. I me pëlqimin e tij i është zëvendësuar dënimi me burgim i cekur si më lartë në dënim me gjobë në shumën dymijë euro (2000 €), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tre (3) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Është udhëzuar i akuzuari se nëse nuk i paguan dënimet me gjobë që shumë e përgjithshme e tyre është prej dymijë e pesëqind euro (2500 €) brenda afatit të caktuar si më lartë, atëherë dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim me burg duke iu llogaritur një ditë burg për çdo 20 euro të gjobës.

Konform nenit 367 par.5 të KPRK-së janë konfiskuar:

Substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshë neto 12 gram dhe “Gjoint” me substancë të dyshuar narkotike të llojit “Marihuanë me peshë prej 1.1 gram, e cila pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të asgjësohet;

Një telefon mobil i llojit “Iphone 11”, ngjyrë e zezë, me SIM kartelë “Ipko”, me numër telefoni ... dhe me IMEI ... të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen;

Paratë në shumë prej 265€, në Kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik ....; kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik S...;kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik ... kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik ...; kartëmonedhë 1x50 euro me numër serik ...;kartëmonedhë 1x10 euro me numër serik ...; kartëmonedhë 1x5 euro me numër serik ..., të cilat të holla pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të njëjtat kalohen në buxhetin e shtetit.

Është detyruar Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar që këtë urdhër për konfiskim të e ekzekutoj brenda 10 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50 €), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën pesëdhjetë euro (50 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda e dt. 11.12.2023 dhe ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për të Krime të Rënda PKR.nr.65/2023 i dt. 30.11.2023, ashtu që të ndaj akuzuarit S. I të shqiptohet dënim më i rëndë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.113/2024 e datës 26.02.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda, e ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr. 65/2023 (2023:090891) i dt. 30.11.2023 dhe i njëjti aktgjykim të ndryshohet dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i lartë. Ndërsa, të refuzohet si e pa bazuar përgjigja në ankesën e Prokurorisë Themelore, e ushtruar nga mbrojtësja e të akuzuarit S. I, av. Qendresa Muriqi Mekaj.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë mbrojtësja e të akuzuarit S. I, av. Qendresa Muriqi Mekaj dhe i akuzuari S. I ndërsa Prokurori i Apelit, nuk prezantoi në seancë, ndonëse i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Mbrojtësja e të akuzuarit S. I, av. Qendresa Muriqi Mekaj në seancën e kolegjit deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjegjës në ankesë. Konsideron se vendimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, në rastin konkret edhe zbutja e dënimit ka qenë brenda suazave ligjore, për shkak se i akuzuari ka rënë për herë të parë ndesh me ligjin, ka pranuar fajësinë dhe është baba i dy fëmijëve, me dënimin e shqiptuar konsideron se arrihet qëllimi i dënimit. I akuzuari S. I deklaroi se e mbështes avokaten time.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-se dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtëses të akuzuarit S. I, av. Qendresa Muriqi Mekaj, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë pretendon se Gjykata në mënyrë sipërfaqësore ka theksuar dhe nuk ka arsyetuar se si me dënimin të cilin i ka shqiptuar të akuzuarit, do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe se do të parandalohet i akuzuari që në të ardhmen të kryej ndonjë vepër tjetër penale.

Gjithashtu, Prokurori konsideron se Gjykata përkundër asaj që ka gjetur si rrethanë lehtësuese faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, nuk ka rënë ndesh me ligjin më parë dhe se është baba i dy fëmijëve, nuk ka arsyetuar përse të njëjtit i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj.

Sipas Prokurorit, Gjykata ka mbivlerësuar rrethanën e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si rrethanë lehtësuese, si dhe konsideron se Gjykata me të drejtë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese faktin që i akuzuari nuk ka rënë ndesh me ligjin më parë dhe se është prind, mirëpo të njëjtat nuk është dashur të i marr parasysh me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit.

Po ashtu, Prokurori e konsideron si të pakuptimtë arsyetimin e Gjykatës se Prokuroria nuk e ka arsyetuar propozimin e saj që si rrethanë rënduese të mirret për bazë shkalla e lartë e dashjes, intensitetin e rrezikimit me shpërndarje të kësaj substance tek shoqëria, si dhe ndikimin në shëndetin publik.

Andaj, sipas Prokurorit për shkaqet e lartcekura Gjykata nuk ka përcaktuar drejtë lartësinë e dënimit për të akuzuarin në fjalë. Prokurori konsideron se ndaj të akuzuarit është dashur të shqiptohet një dënim më i rëndë i cili do të përkonte me rrezikshmërinë e vlerave të mbrojtura shoqërore, shkallën e lartë të dashjes së tij dhe qëllimin e dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

#### Pretendimet e mbrojtëses të akuzuarit S. I, av. Qendresa Muriqi Mekaj në përgjigjen në ankesë

Sipas mbrojtëses së të akuzuarit, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe brenda suazave ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit si në dispozitivin e aktgjyqimit të ankimuar. Këtë argument mbrojtja e mbështet duke theksuar se Gjykata e shkallës së parë me të drejtë me rastin e shqiptimit të dënimit është mbështetur në nenin 71 pika 1.3 dhe nenin 72 pika 1.4 e KPRK-së.

Po ashtu, mbrojtësja e konsideron se Gjykata me të drejtë ka marrur parasysh rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit, ndër të cilat ka vlerësuar faktin se i akuzuari më herët nuk ka rënë ndesh me ligjin dhe është baba i dy fëmijëve.

Ndërkaq, sa i përket rrethanave rënduese të propozuara nga Prokurori në aktin akuzues, mbrojtja konsideron se Gjykata të njëjtat me të drejtë i ka vlerësuar si të pa arsyetuara. Madje mbrojtja këto rrethana i konsideron si konstatime abstrakte që kanë qëllim rritjen e vëllimit kinse të dashjes dhe pasojave të veprimeve të akuzuarit.

#### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Ndonëse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore meqë i akuzuar ka pranuar fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë sa i përket vendimit mbi dënimin.

#### Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënimin

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit qysh në fillim, faktin se për Gjykatën nuk ka të dhëna se i akuzuari ka rënë ndesh me ligjin më parë, si dhe faktin që është baba i dy fëmijëve. Ndërsa rrethana rënduese Gjykata e shkallës së parë nuk gjeti, sepse shkalla e lartë e dashjes e cekur nga ana e Prokurorisë në aktakuzë nuk është arsyetuar.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimin i Prokurorit se Gjykata e shkallës së parë ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese dhe gabimisht nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, është pretendimi i pa bazuar pasi në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe mos gjetjes së rrethanave rënduese, dhe si rezultat i tyre të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin përkatës nën minimumin e paraparë me KPRK-së. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer

penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.102/24, datë 27.03.2024

Praktikantja gjyqësore

Erna Stublla

---

Anëtarët e kolegjit

Kadrije Goga Lubishtani

---

Xhevdet Abazi

---

Kryetar i kolegjit

Hashim Çollaku

---